

20220170118

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 25 paragrafi (2) të Ligjit për Mësimdhënësit dhe Bashkëpunëtorët Profesional në Shkollat Fillore dhe të Mesme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19) ministri i arsimit dhe shkencës solli

P R O G R A M **PËR TRAJNIME PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE NË** **SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME PËR VITIN 2022**

Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për zhvillim profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2022.

Neni 2

Trajnimet për zhvillim profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2022 janë nga këto fusha, nënfusha dhe temat e trajnimit:

I. SHKOLLA FILLORE

1. Njohuri për lëndën mësimore dhe për sistemin edukativ-arsimor

1.1 Njohuri për sistemin edukativo arsimor

- Mësim nga distanca: internet aplikimet dhe platformat për mësim,
- Edukimi në kontekst bashkëkohor: zhvillimi i aftësive socio-emocionale te nxënësit,
- Kultura demokratike në shkollë,
- Multikulturalizmi në shkollë njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe,
- Vetëvlerësimi i cilësisë së procesit arsimor në nivel të shkollës,
- Thyerja e barrierave: ndërtimi i një kulture shkollore gjithëpërfshirëse dhe
- Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë.

2. Mësimdhënia dhe të mësuarit

2.1 Planifikimi dhe përgatitja e mësimdhënies

- Planifikimi i orës mësimore duke aplikuar materialet didaktike elektronike në mësimdhënie dhe përdorimi i informacioneve dhe burimeve kompjuterike,
- Inkluzioni dhe qasja në mësimdhënie e nxënësve me nevojaa të veçanta arsimore/vështirësi dhe

- Puna në paralele të kombinuara .

2.2 Realizimi i mësimdhënies

- Aplikimi i qasjeve inovative ndërvepruese në mësimdhënie,
- Mësimdhënia e bazuar në qasjen e problemit,
- Të mësuarit përmes kërkimit, punës me projekte dhe zgjidhjes së problemeve,
- Mësimdhënie për zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit dhe
- Mësimdhënie e orientuar drejt arritjeve të rezultateteve të të mësuarit në nivel më të lartë.

2.3 Vlerësimi i nxënësve

- Hartimi i testeve objektive të njohurive,
- Vlerësim formativ dhe

Aspekte të veçanta për vlerësimin sipas planit arsimor individual.

2.4 Njohja e nxënësve dhe plotësimi i nevojave të tyre

- Zhvillimi profesional dhe këshillimi për karrierën e nxënësve (mentorimi, përcjellja, qasjet për zbulimin e afiniteteve dhe interesave, motivimi dhe zhvillimi, etj.) dhe

- Puberteti dhe adoleshenca - psikologjia e adoleshencës (duke njohur nevojat dhe emocionet).

3. Krijimi i një mjedisi mësimor stimulues

3.1 Krijimi i mjedisit mësimor të sigurt dhe stimulues

- Ballafaqimi me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe bullizmi kibernetik dhe

- Zgjidhja e konflikteve me nxënësit dhe ndërmjet nxënësve.

3.2 Klima në shkollë

- Strategjitë për menaxhim në klasë – parime dhe principe të praktikës së mirë për krijimin e atmosferës së mirë në klasë dhe klasën online/ virtuale dhe

- Mbështetja e nxënësve të cilët me vështirësi përparojnë (tutor /moshatarë, mentorim dhe mësim plotësues).

4. Inkluzioni social dhe arsimor

- Strategjitë, metodat dhe teknikat e punës me nxënës të talentuar dhe

- Qasja praktike në punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

5. Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin

- Bashkëpunim efektiv me prindërit dhe komunitetet lokale, komunat, shoqatat e punëdhënësve dhe punëdhënësve individualë, organizatat/aktivistët e shoqërisë civile dhe partnerët tjerë social.

6. Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional

- Bashkëpunimi profesional i mësimdhënësve (aktivet profesionale, bashkësi për mësim, mentorime etj.)

II. SHKOLLAT E MESME

1. Njohuri për lëndën mësimore dhe për sistemin edukativo-arsimor

1.1 Njohuri për sistemin edukativo-arsimor

- Mësim nga distanca: internet aplikimet dhe platformat për mësim,

- Edukimi në kontekst bashkëkohor: zhvillimi i aftësive socio-emocionale të nxënësit,

- Kultura demokratike në shkollë,

- Multikulturalizmi në shkollë njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe,

- Vetëvlerësimi i cilësisë së procesit arsimor në nivel të shkollës,

- Thyerja e barrierave: ndërtimi i një kulture shkollore gjithëpërfshirëse dhe

- Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë.

2. Mësimdhënia dhe të nxënësve

2.1 Planifikimi dhe përgatitja e mësimdhënies

- Planifikimi i orës mësimore duke aplikuar materiale didaktike elektronike në mësimdhënie dhe përdorimi i informacioneve dhe burimeve kompjuterike,

- Planifikimi bashkëkohor i orës : duke krijuar skenarë në orë dhe materiale mësimore të përshtatura për nxënësit dhe

- Përfshirja dhe qasjet në të mësuarit e nxënësve me nevoja/aftësi të veçanta arsimore/vështërsi dhe

- Metodologjia e mësimit dygjuhëshe.

2.2 Realizimi i mësimdhënies

- Aplikimi i qasjeve inovative ndërvepruese në mësimdhënie,

- Mësimdhënia e bazuar në qasjen e problemit,

- Të mësuarit përmes kërkimit, punës me projekte dhe zgjidhjes së problemeve,

- Mësimdhënia për zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit dhe

- Mësimdhënie e synuar drejt arritjes së rezultateve nga mësimi i nivelit të lartë..

2.3 Vlerësimi i nxënësve
- Hartimi i testeve objektive të njohurive,
- Vlerësimi formues,
- Aspekte të veçanta për vlerësimin sipas planit arsimor individual dhe
- Avancimi i procesit të vlerëimit në arsimin profesional, vendosja e kriterëve të qarta, uniforme dhe transparente për vlerësim.

2.4 Njohja e nxënësve dhe në ballafaqimin e nevojave të tyre
- Zhvillimi profesional dhe këshillimi për karrierën e nxënësve (mentorimi, përcjellja, qasjet për zbulimin e afiniteteve dhe interesave, motivimi dhe zhvillimi, etj.) dhe
- Puberteti dhe adoleshenca - psikologjia e adoleshencës (njohja e nevojave dhe emocionet).

3. Krijimi i mjedisit stimulues për mësim

3.1 Krijimi i mjedisit të sigurt dhe stimulues për mësim

-Ballafaqimi me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe bullizmin kibernetik dhe

- Zgjidhja e konflikteve me nxënësit dhe ndërmjet nxënësve.

3.2 Klima në shkollë

- Strategjitë për menaxhimin e klasës - parimet dhe shembujt e praktikave të mira për krijimin e atmosferës pozitive të punës në klasë dhe në klasën online / virtuale dhe

- Mbështetje për nxënësit që e kanë më vështirë të përparojnë (tutoring me bashkëmoshatarë, mentorim, orë shtesë).

4. Përfshirja sociale dhe arsimore

- Strategjitë, metodat dhe teknika për të punuar me nxënës të talentuar,

- Qasje praktike në punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe

- Standardet dhe kualifikimet për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat profesionale.

5. Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe bashkësinë

- Bashkëpunim efektiv me prindërit dhe bashkësitë lokale, komunat, shoqata e punëdhënësve dhe punëdhënësit individualë, organizatat civile /aktivistët dhe partnerët tjerë social dhe

- Format, fushat dhe mënyrat e bashkëpunimit me bashkësitë e biznesit në arsimin e mesëm profesional.

6. Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional

- Bashkëpunimi profesional i mësimdhënësve (aktivet profesionale, bashkësitë për mësim, mentorimi dhe të ngjashme).

Neni 3

Ky program hyn në fuqi të nesërmen nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.18-797/2

21.1.2022

Shkup

Ministër i arsimit

dhe shkencës,

Doc. d-r **Jeton Shaqiri**, d.v.